

REKACION TEKNIK
Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

Objekti : Rikonstruksioni i rruges “YMER STRINGA”

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

1 – VEND NDODHJA E RRUGES

Rruga “YMER STRINGA” ndodhet ne very-lindje te qytetit te Elbasanit ne lagjen “11 Nentori”

Rruga ka nje gjatesi prej rreth 287 ml dhe fillon nga rruga “Ibrahim Dinçi” ne jug dhe perfundon ne rrugen “Shefqet Daiu” ne veri. Rruga ka nje gjeresi te ndryshueshme me dy vija kalimi.

Fotografi te rruges “Ymer Stringa”



REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa



Kjo rrugë është një rrugë e shtruar me asfalt që është tejte i amortizuar dhe është e gjithë gropa dhe shumë e vështirë në kalim në raste shiu për kembësoret dhe për makinat.

Rrjeti i kanilizimeve të ujërave të zeza është i bërë dhe nuk ka nevojë për rrjet tjetër kanalizimesh.

Rrjeti i kanilizimeve të ujërave të bardha nuk ekziston dhe lind nevoja të bëhet i ri

Rrjeti i ujës jellës ekziston.

Rrjeti i ndricimit ekziston kaotik dhe lind nevoja të bëhet rrjet ndricimi i ri me parametrat bashkekohor.

Rrjeti i IT nuk ekziston dhe do të bëhet i ri.


2 – PLANIMETRIA E RRUGES

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

Rruga qe do te rikonstruktohet do te behet me gjeresi 6 m sipas planit rregullues do te behet me dy vija kalimi sic tregohet dhe ne projekt

Ne te dy anet e rruges vendosen bordure betoni 15x30cm dhe trotuari do te jete me beton te ferkuar dhe me pllaka betonele autoblllokuese t=5 cm




3 – HEQJA E VIJES PROJEKTIT

Ne heqjen e vijes se projektit jane pasur parasysh gjendja egzistuese si dhe kuotat e hyrjes ne banesa e objekte tregtare

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa



4 – INFRASTRUKTURA RRUGORE

a – Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza

Rrjeti I kanalizimeve te ujrave te zeza egziston dhe nuk ka nevoje per rrjet kanalizimesh ujrash te zeza.Do te jete e nevojeshme vetem rregullimi I kokave te pusetave meqe levizin kuotet e rruges.

b – Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te bardha

Rrjeti i kanalizimit te ujrave te bardha sipas shkreses nr.00 dt.000 te ardhur nga Ndermarrja Ujesjelles Kanalizimeve do te behet i ri pasi nuk egziston fare.Ujrat e bardha do te shkarkohen ne kanalim e ujrave te zeza sic eshte sistemi ne te gjithë Elbasanit.

Foto puseta

c – Rrjeti i ujesjellesit

Rrjeti ujesjellesit sipas shkreses Nr.000 dt.00 te ardhur nga Ndermarrja Ujesjelles Kanalizimev egziston dhe nuk do te behet rrjet i ri ujesjellesi.

d – Rrjeti i ndricimit

Linja e re ndricimit do te behet ne anen perndimore te rruges. Shtyllat alnternohen me shtyllat e anes lindore te rruges.

Realizimi i rrjetit te ri te ndricimit do te behet me shtylla xingato me nje krah dhe me lartesi h=7m dhe gjatesi krahu l=1.5m. Te gjitha shtyllat tokezohen me elektroda

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

xingato $h=1.5\text{m}$ dhe me fijen e peste te tokezimit. Ne te gjitha shtyllat vendosen puseta plastike me kapak metalik $40\times 40\times 40$. Thellesia e e shtrirjes se kabllit eshte $h=-0.7\text{m}$ dhe te gjitha lidhjet elektrike realizohen ne morseten e shtylles dhe me kablllo $3\times 16\text{mm}^2$ nga gabina, dhe $4\times 10\text{mm}^2$ nga njera shtylla tek tjetra, $4\times 1.5\text{mm}^2$ do te jete nga bazamenti i shtylles deri te ndricuesi. Distanca ndermjet shtyllave eshte rreth 30 m si ne planimetri e shtyllave per te cilat kjo distance respektohet. Shtyllat e rruges furnizohen nga kabina "Kabina GJYKATA." me kuader elektrik me fotoelement. Ne kuader vendoset 1 automat 40A dhe 1 leshues 40A. Ndricimet jane te tipit IP65 250W i verdhe. Shtyllat te lyhen me varak dhe te montohen.

Foto ndricimit egzistues



e – Rrjeti i telekomunikacionit

Nga ana jone me ane te nje kerkese me Nr 3253 Prot i eshte kerkuar Albtelecom te na pajise me te dhena te detajuara mbi gjendjen aktuale te rrjetit ekzistues te linjave telefonike. Nga ana e Albtelecom eshte bere azhornimi i gjendjes ekzistuese te rrjetit dhe na eshte dhene nje kopje e planimetrise ne shkallen 1-1000 te ketij rrjeti.

Ne kemi shtuar per operatore te tjere dhe per internetin per nevojat e bashkise nje linje tubacioni plastike $O 110\text{ mm}$ per zhvillimin perspektiv te zones ne rrugen "Mustafa BODINI".

f – Sinjalistika rrugore

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

Ne zonen qe rikonstruktohet dhe ne rrugen e re nuk egziston asnje lloj sinjalistike keshtu qe ajo do te behet e re qe nga tabelat e deri tek vijezimet.

g – Gjelberimi , rampat e invalideve dhe kontenieret.

Vendet e konteniereve te rinj jane bere ne bashkepunim me drejtorine perkatese. Rampat e invalideve jane bere ne cdo vend ne hypje e zbritje trotuari.

Ne trotuare vendosen peme te ndryshme sipas projektit bashkengjitur.

Foto te konteniereve egzistues

4) LLOGARITJA E SHTRESAVE DHE E NENSHTRESAVE

Kjo rruge do te trajtohet vetem me riveshje duke ruajtur konturet egzistuese te rruges

Koncepti i rruges se re ndryshe nga e vjetra konsiston ne skarifikimin e rruges egzistuese nga ku do te hiqet shtresa e asfaltit , binderit dhe stabilizantit. Shtresa e sipërme te jete me asfalto-beton me trashesi 4 cm .Per rrjedhoje poshte shtreses se asfalto-betonit vijne me rradhe 5 cm shtrese binder 10 cm shtresa e stabilizantit dhe dy shtresat e bazamentit te cilat jane 10 cm zhavor dhe 15cm çakell elementet e te ciles dalin nga llogaritjet e marra nga literatura (MODELLO DI CATALOGO DELLE PAVIMENTAZIONI STRADALI) si dhe nga KTP-89 . Nga kushtet konstruktive duhet qe te permiresohen ndjeshem cilesite fiziko-mekanike te tabanit te tokes. Kjo arrihet duke ndertuar shtresa zhavorrike me fraksione te ndryshme, te ngjeshura mire dhe te lara. Trashesia e ketyre shtresave vendoset ne baze te kushteve konstruktive KTP-89. Ne figuren 2 eshte paraqitur skematikisht stratifikimi i ri per segmentin tone. Perpara fillimit te llogaritjeve duhet qe te disponojme disa te dhena paraprake si te dhenat mbi trafikun, tonazhi i lejuar, karkteristikat fiziko mekanike te tabanit te tokes ku mbeshteten shtresat tona.

Shtresat ekzistuese te rruges pas prerjes studimore jane si ne fotot e meposhtme. Ne fillim jane shtresat asfaltike ne thellesine 9 cm te cilat vijne siper shtreses se stabilizantit cm dhe nen to shtresa me zhavor . Me poshte vijne shtresat argjilore me ngyre te kafe dhe blu te erret. Karakteristikat fiziko-mekanike jane dhene si me poshte:

SHTRESAT RRUGORE

Dimensionimi i shtresave dhe verifikimi i tyre eshte bazuar ne

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

MODELLO DI CATALOGO DELLE PAVIMENTAZIONI STRADALI

L. Domenichini, P. Di Mascio

P. Giannattasio, C. Caliendo, B. Festa

A. Marchionna, P. Finni, E. Molinaro, G. Paoloni

Karakteristikat paraprake baze jane:

Trafiku ne jetegjatesine 15-20 vjecare te rruges

Ulja elastike e lejuar 0.51 mm

Automjeti njesi eshte automjeti me ngarkese ne aksin e mbrapem 81.6 kN ngarkese boshtore.

Shtresat e reja me beton dimensionohen ne baze te teorise se elasticitetit me deformim elastik te lejuar nen rroten e automobilit qe dimensionohet.

Te dhena te tjera baze per projektimin e shtresave rrugore jane:

Ngarkesa e trafikut me akse standart per jetegjatesine 20 vjecare te veperes:
 $W18= 3\text{deri}5 \times 10^6 \text{ ESAL}$ (mjete njesi standart 81.6 kN per aks)

Besueshmeria: 95%

Devijimi i pergjithshem standart $S_0=0.44$

Moduli resilent i tabaneve (duke marre parasysh rastet me te disfavorshme
 $M_r=35 \text{ Mpa}$

Humbja e sherbimit te projektimit $\Delta PSI=2$

Trafiku konsiderohet "i rende deri i mesem": $3\text{-}5 \times 10^6 \text{ AADT}$ ne jetegjatesine 15-20 vjecare te rruges;

Trafiku llogarites, duke patur parasysh se kemi te bejme me nje rruge te re, i koospondon nje trafikut 1 000 deri 2 000 aut njesi/24 ore, percaktuar ne "Raportin Teknik te Studimit te Trafikut te Rruges" (v.2005). Ne dimensionimin e shtresave rrugore merren ne konsiderate materialet rethanore si dhe kushte te tjera gjeologjike, hidrologjike dhe klimatike.

Kompozimi i metejshe i shtresave rrugore (bashkelidhur jane paraqitur llogaritjet) mendohet te jete:

Themeli dhe nenthemeli i rrugëve lidhese qe jane pa asfalt do te jene ;

Keto jane projektuar me kete perberje:

shtresa ne mbushje:

REKACION TEKNIK

Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

Paketa e mbushjes Paketa e mbushjes:

⇒ 10 cm zhavor

shtresa e perdorimit:


Paketa e perdorimit Paketa e perdorimit, ka kete perberje:

⇒ 10 cm stabilizant

⇒ 5 cm binder

⇒ 4 cm asfaltobeton

Gjithsej paketa e perdorimit eshte parashikuar 9 cm, gje qe garanton jetegjatesine dhe fortesine e tyre per nje trafik te cilesuar “te mesme” te rruges se ardhshme Me ne detaje shtresat e rruges tregohen ne llogaritjet dhe vizatimet e punes se profilave terthor tip qe shoqerojne kete raport teknik.



SHENIM : Para fillimit te punimeve firma fituese e tenderi duhet te konsultohet me ndermarrjet Ujesjelles Kanalizime , OSSH , Albatelekomit per thellesine e vendosjes se linjave perkatese dhe pozicionin e tyre pavarsisht projektit azhornues te dhene nga to .

REKACION TEKNIK
Rikonstruksion i rruges Ymer Stringa

Linjat e telekomunikacionit jane aktualisht te vendosura 30 ~ 40 cm nen toke dhe linjat e objekteve te tjera deri ne 70 cm nen toke.

Ne rast te demtimit te linjave te mesiperme nga firma zbatuese pergjegjesia do te bjere mbi firmen.

HARTOI

Ing.Hidroteknik Erion STAMBOLLXHIU

Ing.Eleketrik Kleodjan BIXI

Ing.Eleketrik Nazmi TANUSHI

Sinjalistika rrugore Ing. Irma GJOSHI

DREJTORI DPTP

Ark.Gentian TABAKU

Pergjegjesi SPRI

Ark.Marvis AVLLAZAGAI

KRYETARI BASHKISE

Qazim SEJDINI